

# Integrimi i RS-ve në Buxhet Rasti i Kosovës

Valmira Rexhëbeqaj



Financuar nga Bashkimi Evropian

# Struktura e prezantimit

- Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**
- Qasja në gjetjen e hapësirën fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**
- Qasja në integrimin e përgatitjes së buxhetit me planifikimin e politikave- **Pjesa 3**

# Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**

- **Korniza Afatmesme e Shpenzimeve**
- KASH përmban prioritetet strategjike të QK-së dhe vitin fiskal dhe vlerësimet për dy vitet në vijim. **Objektivat e detajuara makroekonomike dhe fiskale që duhet të udhëheqin procesin buxhetor, që i mbulon dy vitet e ardhshme.**
- Objektivat fiskalë kuantifikohen në kuptim të synimeve për sa i përket deficitit fiskal, burimeve të financimit, shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisë qendrore, ndryshimeve në stokun e aktiveve dhe detyrimeve financiare.
- Afati i fundit për miratimin e KASH-it nga Qeveria është jo më vonë se **30 prilli i vitit fiskal.**



# Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**

- Procesi zyrtar i planifikimit të buxhetit fillon në **mesin e muajit maj**, kur nxirren **Qarkoret e para buxhetore** nga Ministria e Financave për Organizatat Buxhetore
- Qarkorja e parë buxhetore ofron udhëzimet e para për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal **"N" dhe "N+1" dhe "N+2"**,
- Qarkorja e parë Buxhetore përmban tavane buxhetore indikative sipas **kategorive ekonomike për secilën OB**, dhe afatet kohore për hartimin e buxhetit
- Tavanet indikative të caktuara me qarkoren e parë bazohen **në tavanet e KASH-it.**

# Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**

- Qarkorja e dytë buxhetore përgatitet vetëm nëse është e nevojshme, që mund të ndodhë për shkak të rrethanave të paparashikuara
- Pas dorëzimit të qarkoreve buxhetore secila OB është përgjegjëse për të përgatitur dhe për t'ia dorëzuar Ministrit buxhetin e saj të propozuar dhe kërkesën për ndarje buxhetore në përputhje me:
  - (i) tavanin e aplikuar të shpenzimeve, nëse ka; (ii) informacionet dhe udhëzimet e dhëna në qarkoren buxhetore; dhe (iii) në rastin e komunës, shumat e aplikueshme të grantit të llogaritura në përputhje me formulat e specifikuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

# Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**

- Në Qarkoren e parë Buxhetore, OB-të këshillohen që të miratojnë dhe prioritizojnë politikat e tyre brenda tavaneve të dhëna.
- Gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre, OB-të këshillohen t'i japin përparësi:
  1. Projekteve që ndihmojnë në realizimin e prioritetëve qeveritare të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021 dhe Programin e Reformës Ekonomike 2019-2021.
  2. Projektet që janë në vazhdim e sipër nga vitet e kaluara dhe kanë detyrime kontraktuese,
  3. Zotimet e qeverisë për Planin i Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe programit - Instrumenti i Para-anëtarësimit (IPA), □

# Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**

4. Legjislacion i ri ose plotësim ndryshimi i atij ekzistues,
5. Përfshini në ndarjet buxhetore detyrimet e financimit të jashtëm të projekteve individuale,
6. Sigurohuni që ato të hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm për aq sa u lejon korniza e tyre buxhetore.

# Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**

- Pas marrjes së kërkesave buxhetore, zhvillohet një seri dëgjimesh buxhetore për kërkesat ndërmjet MF-së dhe OB-ve gjatë gushtit/shtatorit.
- Gjatë procesit të dëgjimit të buxhetit, Ministria e Financave angazhohet në një debat të hapur me OB-të, në rastet kur kërkesat për buxhet të një organizate buxhetore tejkalojnë tavanin e tanishëm buxhetor.
- Në rastet kur ka arsye të duhura nga OB-të, Ministria e Financave në konsultim me OB-të mund të ndryshojë/përshtat tavanet e OB-së
- Këto ndryshime pasqyrohen në Qarkoren e dytë Buxhetore të lëshuar nga MF




# Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**



- Qarkorja e dytë përbën Tavanet përfundimtare buxhetore për Organizatat Buxhetore
- Këto tavane buxhetore në të ardhmen mund të ndryshohen vetëm nga Qeveria dhe Kuvendi - duke respektuar tavanet e jashtme buxhetore
- **Pas aprovimit nga Qeveria, Ministri i Financave duhet të dërgojë buxhetin e propozuar të konsoliduar, Ligjin e propozuar të ndarjes buxhetore dhe KASH-in e përditësuar në Kuvendin e Kosovës jo më vonë se 31 tetor (neni 22 i LMFPP-së).**

# Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**

## Nga lart-poshtë MF



## Nga poshtë - lart **MINISTRITË E LINJËS**



**PARLAMENTI**



# Qasja e përgjithshme në përgatitjen e buxhetit në vend- **Pjesa 1**

## **Sllajdi përmbyllës - Pjesa 1**

- 1. Procesi buxhetor i përcaktuar mirë dhe i bazuar në ligje**
- 2. Qasje të përziera nga poshtë-lart / nga lart-poshtë**
- 3. Roli i KASH-it të rritet gjatë procesit të buxhetit**
- 4. Kosova ende nuk ka përvetësuar praktikën e përcaktimit të tavaneve të forta të shpenzimeve në KASH**
- 5. Në realitet, dobia e KASH-it në përgatitjen e buxhetit vjetor është e kufizuar**

# Qasja në gjetjen e hapësirën fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

- Kostimi i nismave të reja rregullohet nga:
  - Rregullorja e Qeverisë
  - Udhëzimi Administrativ Nr. 03/205 për Vlerësim të Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare.
- UA Nr. 03/205 - Nismat e Reja do të thotë çdo Nismë e re ose një rishikim i një nisme ekzistuese (Strategjitë sektoriale, ligjet, koncept dokumentet dhe çdo legjislacion tjetër), e cila propozohet nga një Organ Propozues për miratim në Takimin e Qeverisë
- Iniciativat e reja: përfshirë ato në PRE - Qarkorja buxhetore - projektet prioritare, ato të përfshira në PRE

# Qasja për gjetjen e hapësirën fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

## Procedura për të propozuar dhe vendosur për financimin e nismave të reja të politikave

- Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor (VNB): nënkupton procesin e vlerësimit të ndikimit që ka nisma e re në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Prandaj, bazuar në këtë përkufizim, OB duhet të vlerësojë vetëm koston që do të ketë zbatimi i nismës së re për buxhetin e Kosovës
- VNB - do t'i paraqitet nga Ministritë e linjës Ministrisë së Financave si pjesë e konsultimit ndërministror

# Qasja për gjetjen e hapësirën fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

## Procedura për të propozuar dhe vendosur për financimin e nismave të reja të politikave

- Departamenti i Buxhetit i MF-së, harton një Opinion të Pavarur i cili përshkruan të gjitha lëshimet ose vlerësimet jorealiste të ndikimit buxhetor, dhe ia kthen atë përsëri Organit Propozues
- VNB i përcaktuar - burimet e financave:
  - Opsionet e kursimit- brenda kufijve buxhetorë aktual
  - Kërkohen fonde shtesë -
    - a) Kërkesë shtesë për buxhet gjatë procesit të formulimit të buxhetit; ose
    - b) Ndryshimet në buxhetin aktual të aprovuar nga Qeveria dhe Kuvendi;



# Qasja për gjetjen e hapësirën fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

## Procedura për të propozuar dhe vendosur për financimin e nismave të reja të politikave

- Huamarrja, do të thotë që propozuesi synon të financojë nismën, plotësisht ose pjesërisht, përmes fondeve të huazuara të cilat eventualisht do të bëhen pjesë e tavanit buxhetor.
- Partnerët zhvillimorë, nënkupton që propozuesi synon të financojë nismën, plotësisht ose pjesërisht, duke përdorur grantet e donatorëve.
- Financim tjetër (PPP), Partneritetet Publiko-Private janë një formë tjetër e financimit; të cilën mund ta përdorin Organizatat Buxhetore nëse një formë e tillë është e



# Qasja për gjetjen e hapësirën fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

## Procedura për të propozuar dhe vendosur për financimin e nismave të reja të politikave

- VNB - Metodologjia në përputhje me metodologjinë e kostimit të PRE-së
  - Qasja nga poshtë-lart
  - Kostimi inkremental (duke u rritur)
  - Vlerësime tri vite më përpara
  - Vetëm masat e reja në vitin e parë të PRE-së konsiderohen si nisma të reja të politikave gjatë procesit të buxhetit
  - Vlerësimi i ndikimit buxhetor - konsiderohet gjatë fazës së buxhetimit
  - Masë e re e PRE-së brenda planifikimit të buxhetit të OB-së





# Qasja për gjetjen e hapësirën fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

## **Procedura për të propozuar dhe vendosur për financimin e nismave të reja të politikave**

- PRE ndonjëherë përdoret si “mjet” për prioritizimin e politikave
- Përfshirja e politikave të reja në PRE - fuqia e negocimit gjatë negociatave për buxhetin ML dhe MF
- Prioritizimi i politikave të reja ende nuk bazohen plotësisht në dëshmitë e kostimit
  - Ende vazhdon të ketë ndikim politik!
- Sidoqoftë, disa shembuj të mirë përgjatë viteve:



# Qasja për gjetjen e hapësirës fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

## **Shembuj të PRE- Buxhetit**

1. **Rritja e efikasitetit të gjyqësorit përmes zvogëlimit të lëndëve gjyqësore të prapambetura -PRE 2018:**
  - Kostoja totale e masës 2018-2020 mbi 8,000,000
  - Kostimi i detajuar i secilit aktivitet
  - Burimet e financimit të përcaktuara mirë: Buxheti i Kosovës, Kreditë e donatorëve të tjerë.
  - PRE 2019 thekson se të gjitha aktivitetet janë zbatuar plotësisht
  - Burimet financiare të buxhetuara dhe të siguruara me kohë

# Qasja për gjetjen e hapësirës fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

## **Shembuj të PRE- Buxhetit**

1. **Masa e Reformës Nr. 3: Ndryshimet strukturore në sektorin e bujqësisë- PRE 2020:**
  - Kostimi i detajuar i secilit aktivitet
  - Aktiviteti i ri i propozuar: **Zhvillimi i softuerit për Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë**
  - Burimet e financimit të planifikuara në Buxhetin e Kosovës 2020
  - Kostimi i PRE-së i marrë parasysh gjatë përgatitjes së buxhetit

# Qasja për gjetjen e hapësirës fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

## Sllajdi përmbyllës - Pjesa 2

1. Kosova ka zhvilluar një proces të kënaqshëm për kostimin e nismave të reja bazuar në Udhëzimin Administrativ
2. Janë krijuar disa praktika të mira për sa i përket koordinimit të politikave dhe kostimit, megjithatë procesi i përgjithshëm duhet të forcohet më tej- **në disa raste, cilësia e kostimit mbetet e dobët/ jorealiste**
3. **Lidhja në mes të strategjitë sektoriale (nismave të reja) - KASH - Buxhetit nuk është akoma në nivelin e dëshiruar**
4. Ministritë e linjës dhe agjencitë duhet të forcojnë kapacitetet e tyre sa i përket planifikimit të politikave dhe kostimit

# Qasja për gjetjen e hapësirës fiskale për nisma të reja të politikave - **Pjesa 2**

## Sllajdi përmbyllës - Pjesa 2

1. Kosova ka zhvilluar një proces të kënaqshëm për kostimin e nismave të reja bazuar në Udhëzimin Administrativ
2. Janë krijuar disa praktika të mira për sa i përket koordinimit të politikave dhe kostimit, megjithatë procesi i përgjithshëm duhet të forcohet më tej- në disa raste, cilësia e kostimit mbetet e dobët/ jorealiste
3. Lidhja në mes të strategjitë sektoriale (nismave të reja) - KASH - Buxhetit nuk është akoma në nivelin e dëshiruar
4. Ministritë e linjës dhe agjencitë duhet të forcojnë kapacitetet e tyre sa i përket planifikimit të politikave dhe kostimit



# Qasja për integrimin e përgatitjes së buxhetit me planifikimin e politikave-

## Pjesa 3

- **Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (SKZH) 2016 -2021 - përcaktimi i prioriteteve kryesore të qeverisë**
- **Koordinimi i KASH-it dhe PRE-së u nda në mes të MF-së dhe ZPS-së**
- **KASH 2020-2022**
  - Pjesa 1: Deklarata e Prioriteteve (ZPS) - bazuar në SKZH - 5 shtyllat kryesore/ prioritetet e PRE-së
  - Pjesa 3: Shpenzimet sektoriale (MF) - klasifikimi COFOG





# Qasja për integrimin e përgatitjes së buxhetit me planifikimin e politikave-

## Pjesa 3

- **KASH** udhëheq procesin e buxhetimit
- **MBANI MEND - QARKORJA BUXHETORE 1 KËRKESA**
  - Projektet që ndihmojnë në realizimin e prioriteteve qeveritare të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021 dhe Programin e Reformës Ekonomike 2019-2021.
  - Zotimet e qeverisë për Planin i Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe programit - Instrumenti i Para-anëtarësimit (IPA).
- Harmonizim i kënaqshëm ndërmjet dokumenteve të planifikimit të politikave
- ML - Propozimet buxhetore të harmonizuara me projektet specifike të PRE-së dhe IPA-s





# Qasja për integrimin e përgatitjes së buxhetit me planifikimin e politikave-

## Pjesa 3

- Buxheti i dorëzuar në Parlament ndër të tjera përmban:
- Aneksin 1- Korniza makro fiskale - përshkrimi narrativ i të hyrave dhe shpenzimeve
- Seksioni 2.3.2.1 i këtij aneksi - përshkruan:
  - Shpenzimet për Prioritetet e Qeverisë - që rrjedhin nga Prioritetet e SKZH-së dhe PRE-së
  - Përshkrimet e shpenzimeve grumbullohen nën klasifikimin kryesor të COFOG: a) sundimi i ligjit dhe siguria publike, b) shëndeti, c) arsimit, d) mbrojtja e mjedisit, e) ndërmarrësia







## buxhetit me planifikimin e politikave-

### Pjesa 3

#### Sllajdi përmbyllës - Pjesa 3

1. **KASH 2021-2024 - proces i përmirësuar i koordinimit në mes të ZPS-së dhe MF-së**
2. **Harmonizimi i objektivave strategjike me Shpenzimet sektoriale bazuar në COFOG**
3. **Objektivat Strategjikë - në përputhje me prioritetet e PRE-së dhe Planin Vjetor të Qeverisë**
4. **Koordinim më i mirë me MF**



# Pyetje për debat

- **A mund të rritet roli i KASH-it gjatë procesit buxhetor**
  - Përcaktimi e tavaneve të forta të shpenzimeve në KASH?
  - Ulja e mospërputhjeve në mes të parashikimeve të KASH dhe Buxhetit Vjetor?
- **A kostohen të gjitha nismat e reja të politikave?**
  - Roli i Departamentit të Buxhetit në shyrtimin e tyre?
  - A është ndjekur si duhet UA për kostimin e nismave të reja nga ML-të?
  - Si të përmirësohen më tej kapacitetet e kostimit brenda ML-ve?
- **A janë masat prioritare të PRE-së të pasqyruara mirë në buxhetin vjetor**
- **Hapësira fiskale për masa të reja të mundshme të PRE-së pas adresimit të masave të emergjencës/ rimëkëmbjes ekonomike nga COVID 19?**